



BQK publikon të dhënat e sektorit të jashtëm për gjashtëmuajorin parë të vitit 2013

Kumtesë për shtyp
30 Shtator 2013

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka publikuar statistikën e sektorit të jashtëm, që përfshin: statistikën e bilancit të pagesave, pozicionit të investimeve ndërkombëtare si dhe statistikën e borxhit të jashtëm të Kosovës, për gjysmën e parë të vitit 2013. Të dhënat janë publikuar në kuadër të [Serive Kohore](#) në faqen e internetit të BQK-së, sipas kalendarit të publikimeve t+90 (90 ditë pas periudhës referuese).

Për më shumë, të dhënat e publikuara janë konform standardeve statistikore ndërkombëtare dhe përfshin komponentët standarde siç janë: mallrat, shërbimet, të ardhurat, transferet rrjedhëse (remitancat), investimet e huaja direkte, investimet jashtë vendi në depozita, letrat me vlerë, pozicionin e investimeve ndërkombëtare, asetet dhe detyrimet e jashtme sipas sektorëve, gjendja kumulative e investimeve të huaja direkte sipas shteteve dhe instrumenteve, rezervat ndërkombëtare, borxhin e jashtëm të Kosovës sipas sektorëve, etj.


Këto informata njëherësh janë të shpërndara edhe në FMN-së, në publikimin Statistikat Financiare Ndërkombëtare (anglisht: [International Financial Statistics](#) – IFS) dhe në Bankë Botërore (anglisht: [Quarterly External Debt Statistics](#) – QEDS).

Në vazhdim është dhënë një pasqyrë e përmblodhur që karakterizon gjashtëmuajorin e parë të vitit 2013 në fushën e bilancit të pagesave, pozicionit të investimeve ndërkombëtare dhe borxhit të jashtëm. Në fund është paraqitur edhe një shtojcë statistikore lidhur komponentët kryesore.

Bilanci i pagesave të Kosovës

Deficiti i llogarisë rrjedhëse në gjysmën e parë të vitit 2013 shënoi vlerën 147.6 milion euro. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak deficiti ka qenë më i lartë për 5.8 milion euro. Kontribuuesi kryesor i deficitit të llogarisë rrjedhëse mbetet kategoria e mallrave (bilanci tregtarë në mallra) që në gjysmën e parë të vitit 2013 arriti vlerën 923.7 milion euro dhe kishte një nivel të njëjtë me atë të vitit paraprak. Në anën tjetër, kontribuuesit kryesorë në zbutjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse janë transferët rrjedhëse (563.3 milion euro), shërbimet (137.9 milion euro) dhe të ardhurat (74.9 milion euro). Në kuadër të transfereve rrjedhëse, remitencat në gjysmën e parë të vitit 2013 shënuan vlerën prej 272.4 milion euro, 4.2% më shumë se periudha e njëjtë e vitit 2012. Investimet e huaja direkte (IHD) si një ndër komponentët me peshën më të madhe në kuadër të llogarisë financiare, në gjysmën e parë të vitit 2013 kanë shënuar rritje të theksuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. IHD-të në gjysmën e parë të vitit 2013 arritën vlerën neto prej 143.9 milion euro. Rritjes së investimeve i ka kontribuar më së shumti privatizimi i shpërndarësit të energjisë elektrike (KEDS), pastaj rritja e investimeve në patundshmëri si dhe rritja e investimeve të kompanive ekzistuese që janë në relacion të investimeve të huaja direkte. Investimeve në letra me vlerë të jorezidentëve ishin 135.2 milion euro dhe krahasuar me vitin paraprak ishin për dy herë më të larta.


Figura 1. Deficiti i llogarisë rrjedhëse, të dhëna jokumulative, në miliona euro



Pozicioni i investimeve ndërkombëtare

Kosova vazhdon të jetë neto kreditor ndaj pjesës tjetër të botës. Krahasuar me tremujorin paraprak, asetet e jashtme neto nuk kanë pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm dhe mbeten në nivelin prej 3.85 miliardë euro. Në anën tjetër, detyrimet janë rritur për 3.6% dhe duke shënuar vlerën prej 3.57 miliardë euro. Rritjes së detyrimeve të huaja më së shumti i ka kontribuar rritja e investimeve të huaja në Kosovë dhe rritja e kredive tregtare. Kosova vazhdon të regjistrojë bilanc neto pozitiv të pozicionit të investimeve ndërkombëtare i cili në fund të tremujorit të dytë të vitit 2013 ishte 281.7 milion euro.


Figura 2. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare, të dhëna kumulative, në miliardë euro



Borxhi i jashtëm i Kosovës

Borxhi i jashtëm bruto i Kosovës, i cili përfshinë borxhin privat dhe borxhin publik, në fund të qershorit 2013 arriti vlerën 1.5 miliardë euro, 9% më i lartë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Borxhi publik ka një pjesëmarrje të ulët në gjithsej borxhin e jashtëm bruto (394.8 milionë euro apo 26 % e borxhit të jashtëm bruto). Pjesa më e madhe e borxhit publik përbëhet nga borxhi i jashtëm i qeverisë i cili në fund të qershorit 2013 ishte 331.1 milionë euro. Rritja e borxhit qeveritar kryesisht i atribuohet kredisë nga FMN-ja në kuadër të programit Stand-By që Kosova ka me FMN-në.

Figura 3. Borxhi i jashtëm bruto, të dhëna kumulative, në miliardë euro



Shënim: Në kuadër të borxhit publik është përfshirë edhe alokimi i SDR-ve nga FMN-ja

Borxhi i sektorit privat, i cili në fund të qershorit 2013 shënoi vlerën prej 1.1 miliardë euro, përbën 74% të borxhit të jashtëm bruto të Kosovës. Pjesa më e madhe e borxhit privat është në formë të kredive ndërmjet kompanive që janë në relacion të investimeve të huaja direkte (612.4 milion euro) e pasuar nga huamarrjet e bankave komerciale (183 milion euro). Sektorët e tjerë të ekonomisë (institucionet financiare jobankare, korporatat jofinanciare, organizatat joqeveritare dhe ekonomitë familjare), në fund të tremujorit të dytë të vitit 2013 kanë pasur një borxh bruto prej 324.1 milion euro. Në këto kategori dominojnë kreditë tregtare të kompanive kosovare importuese të mallrave.

Shtojca statistikore

Tabela 1. Bilanci i pagesave

(Të dhëna jokumulative, në milionë euro)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2012				2013	
				T1	T2	T3	T4	T1	T2
Llogaria rrjedhëse	-515.7	-658.4	-380.2	-20.9	-120.9	-143.5	-94.9	-13.4	-134.2
Mallrat	-1,752.1	-2,059.0	-2,072.8	-372.9	-548.8	-612.0	-539.1	-389.7	-534.0
Eksporti (f.o.b.)	305.0	324.9	286.9	61.5	78.9	72.0	74.6	71.2	80.4
Importi (f.o.b.)	-2,057.1	-2,383.9	-2,359.7	-434.4	-627.7	-683.9	-613.7	-460.9	-614.2
Shërbimet	186.9	265.7	346.2	47.4	81.4	129.2	88.0	59.5	78.3
Eksporti	572.9	618.4	635.0	106.5	146.9	227.3	154.2	104.5	146.9
Importi	-386.0	-352.7	-288.8	-59.1	-65.5	-98.0	-66.1	-45.0	-68.6
Të ardhurat	67.0	113.7	154.1	37.4	44.3	20.3	51.9	42.4	32.5
Kredi	176.8	241.2	230.5	59.3	58.3	56.3	56.4	57.2	55.4
Debi	-109.8	-127.4	-76.4	-21.9	-13.9	-36.0	-4.4	-14.8	-22.9
Transferat rrjedhëse	982.4	1021.0	1192.3	267.2	302.1	318.8	304.1	274.3	288.9
Kredi	1087.4	1133.5	1296.4	293.5	328.1	345.2	329.4	294.3	309.4
Debi	-104.9	-112.4	-104.0	-26.3	-26.0	-26.3	-25.3	-20.0	-20.4
Llogaria kapitale	21.3	42.0	12.9	-0.8	2.4	-1.6	13.0	9.6	3.1
Kredit	35.7	57.6	31.6	2.7	7.1	2.8	18.8	10.0	7.0
Debit	-14.4	-15.6	-18.6	-3.6	-4.6	-4.5	-5.7	-0.4	-3.9
Llogaria financiare	275.8	377.5	130.3	13.7	75.8	-26.0	66.7	-8.3	152.0
Investimet e huaja direkte	331.1	378.9	213.2	54.9	23.4	88.5	46.2	57.0	81.2
Jashtë vendit	-34.7	-15.6	-15.7	-1.7	-6.3	-3.7	-3.9	-3.0	-2.6
Në Kosovë	365.8	394.5	229.0	56.3	29.8	92.2	50.2	60.1	83.8
Investimet në letrat me vlerë	-49.2	-56.9	-184.9	-80.7	37.0	-163.2	22.0	-53.4	-82.7
Asetet	-48.5	-57.7	-185.6	-80.9	37.0	-163.2	21.5	-53.5	-81.7
Detyrimet	-0.7	0.8	0.7	0.2	0	0	0.5	0	-1.0
Investimet e tjera	47.3	-5.6	369.2	47.5	32.1	254.8	34.5	-18.3	168.1
Asetet	-266.2	-81.6	146.3	112.7	-27.4	107.7	-46.6	39.7	99.4
Detyrimet	313.5	76.0	222.8	-65.1	59.6	147.1	81.2	-58.0	53.8
Asetet rezervë	-53.3	61.2	-267.2	-8.0	-16.8	-206.1	-36.2	6.3	-14.6
Gabimet dhe harresat	217.5	239.5	236.8	7.9	42.5	171.2	15.1	11.2	-20.9

Tabela 2. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare

(Të dhëna kumulative, në milionë euro)

Përshkrimi	2010	2011	2012				2013	
			T1	T2	T3	T4	T1	T2
PIN Neto	428.8	133.9	230.4	173.1	236.6	248.8	405.9	281.7
Asetet	3,246.7	3,325.1	3,344.0	3,352.7	3,634.0	3,705.1	3,847.4	3,848.4
Investimet direkte jashtë vendit	86.4	102.0	103.8	110.2	113.9	117.8	120.9	123.5
Investimet në portofolio	693.8	740.2	860.6	814.5	998.7	986.6	1,073.1	1,138.1
Letrat me vlerë të kapitalit	194.2	296.0	348.4	397.7	324.7	354.1	396.6	396.6
Letrat me vlerë të borxhit	499.6	444.3	512.3	416.8	674.0	632.5	676.5	676.5
Derivatët financiarë	-	-	-	-	-	-	-	-
Investimet tjera	1,832.0	1,908.2	1,798.8	1,827.1	1,715.6	1,760.6	1,820.0	1,820.0
Kreditë tregtare	5.7	1.0	1.0	1.0	1.0	1.2	1.2	20.4
Kreditë	29.0	52.1	59.0	58.2	79.1	81.3	94.4	84.5
Paraja e gatshme dhe depozitat	1,797.3	1,855.0	1,734.7	1,763.1	1,633.3	1,673.9	1,721.3	1,631.8
Asetet tjera	-	-	4.1	4.9	2.1	4.3	3.1	4.3
Asetet rezervë	634.5	574.7	580.9	600.9	805.8	840.0	833.4	846.2
Detyrimet	2,817.8	3,191.2	3,113.6	3,179.6	3,397.3	3,456.3	3,441.4	3,567.0
Investimet direkte në Kosovë	1,960.8	2,326.1	2,368.3	2,385.3	2,472.5	2,524.3	2,582.2	2,664.3
Investimet portofolio	1.3	2.1	1.3	0.7	0.7	0.5	1.8	0.7
Letrat me vlerë të kapitalit	1.3	2.1	1.3	0.7	0.7	0.5	1.8	0.7
Letrat me vlerë të borxhit	-	-	-	-	-	-	-	-
Derivatët financiarë	-	-	-	-	-	-	-	-
Investimet tjera	855.7	863.0	744.1	793.7	924.1	931.4	857.4	902.0
Kreditë tregtare	144.2	178.2	115.8	167.3	219.6	199.8	120.7	159.2
Kreditë	540.4	512.5	475.6	472.8	515.5	541.3	537.4	564.9
Paraja e gatshme dhe depozitat	106.9	105.5	85.1	82.1	115.4	120.9	130.6	109.4
Detyrimet tjera	64.2	66.8	67.6	71.5	73.5	69.5	68.8	68.5

Tabela 3. Borxhi i jashtëm

(Të dhëna kumulative, në milionë euro)

Përshkrimi	2010	2011	2012				2013	
			T1	T2	T3	T4	T1	T2
Borxhi publik dhe borxhi publik i garantuar	325.9	320.0	312.7	321.1	361.2	401.4	397.9	394.8
Qeveria	260	253.6	247.4	253.6	294.2	336.5	332.8	331.1
Afatshkurtër	-	-	-	-	-	-	-	-
Afatgjatë	260	253.6	247.4	253.6	294.2	336.5	332.8	331.1
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	65.9	66.4	65.3	67.5	66.9	65	65.1	63.8
Afatshkurtër	1.7	0.7	1.1	0.7	0.9	0.4	0.3	0.1
Afatgjatë	64.2	65.7	64.2	66.7	66	64.6	64.8	63.7
Borxhi i sektorit privat	1,022.4	1,106.70	1,020.2	1,064.1	1,175.8	1,116.2	1,052.2	1,119.5
Bankat	222.3	196.4	162.1	151	184.1	175.6	181.8	183.0
Afatshkurtër	222.3	195.2	162.1	151	184.1	175.6	181.8	183.0
Afatgjatë	-	1.1	-	-	-	-	-	-
Sektorët tjerë	294.4	345	277.2	321.8	378.9	350.9	273.7	324.1
Afatshkurtër	232.7	259.8	191.3	240	340.6	371.5	239.6	279.8
Afatgjatë	61.8	85.1	85.9	81.8	38.3	33.5	34.2	44.3
Investimet direke: kreditimi ndërmjet kompanive	505.7	565.4	581	591.3	612.3	589.7	596.7	612.4
Gjithsej (borxhi i jashtëm bruto)	1,348.3	1,426.8	1,332.9	1,385.1	1,536.9	1,517.6	1,450.1	1,514.3